



Republika Kosovo

Republika Kosovo od Kosovo

Vlada - Vlada - Vlada

Ministarstvo lokalne samouprave

Ministarstvo administracija lokalno samouprava

Ministarstvo od Lokalno Vlada Administracija

Prishtinë, 12.05.2026.

**PYETJET DHE PËRGJIGJET RRETH THIRRJES PËR
THIRRJE PUBLIKE PËR MBËSHTETJE FINANCIARE TË PROJEKTEVE/PROGRAMEVE TË OJQ-
VE NË FUSHËN E QEVERISJES LOKAL**

1. Pyetja nga: Instituti TriPika

Përshëndetje,

Shpresoj që jeni mirë.

Dëshiroj të kërkojm një sqarim lidhur me thirrjen publike për mbështetje financiare të projekteve/programve të OJQ-ve në fushën e qeverisjes lokale.

Konkretisht, një nga kriteret e aplikimit është qarkullimi prej 200,000 € gjatë tre viteve të fundit. A mund të na sqaroni nëse ky kriter mund të plotësohet përmes aplikimit në partneritet me një OJQ tjetër?

Faleminderit paraprakisht për përgjigjen.

Me respekt,

Instituti TriPika

Përgjigja nga MAPL-ja:

I/e nderuar,

Duke u bazuar në Udhëzuesin e thirrjes publike, kriteret e përcaktuara, si dhe në Rregulloren e Ministria e Financave për mbështetje financiare të organizatave joqeveritare, kriteri për qarkullim financiar prej 200,000 € gjatë tri (3) viteve të fundit duhet të plotësohet nga OJQ-ja lidere e aplikimit.

Rrjedhimisht, ky kriter nuk mund të plotësohet përmes kombinimit të qarkullimit financiar me organizata partnere.

Me respekt,

2. Pyetja nga z. Turkan Basa (turkanbasa023@gmail.com)

I nderuar/a,

Shpresoj që ky email t'ju gjejë shëndoshë dhe mirë.

Lidhur me shpalljen publike, kemi disa pyetje për sqarim në lidhje me pikën nr. 10 të listës së dokumenteve:

1. Sa i përket kriterit financiar, a duhet që shuma prej 200,000 € të jetë e saktë, apo lejohet edhe rumbullaksimi i saj?
2. Në rast të aplikimit në partneritet, a duhet që kjo shumë të plotësohet nga secila organizatë veçmas, apo konsiderohet si shumë e përbashkët për të dy organizatat?
3. A merren në konsideratë edhe të hyrat financiare nga vitet paraprake (më shumë se tre vite), apo vlerësohen vetëm tre vitet e fundit?

Ju falënderojmë paraprakisht për përgjigjen tuaj.

Përgjigja nga MAPL-ja

I nderuar/a,

Duke u bazuar në Udhëzuesin e thirrjes publike, kriteret e përcaktuara, si dhe në Rregulloren e Ministria e Financave për kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve:

Kriteri financiar duhet të dëshmojë qarkullim financiar në vlerë prej së paku 200,000 € gjatë tri (3) viteve të fundit, pra shuma mund të jetë 200,000 € ose më e lartë.

Në rast të aplikimit në partneritet, ky kriter duhet të plotësohet nga OJQ-ja lidere e projektit.

Qarkullimi financiar i organizatave partnere nuk merret në konsideratë për plotësimin e këtij kriteri.

Për vlerësim merren parasysh vetëm të dhënat financiare të tri (3) viteve të fundit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në thirrje.

Faleminderit për interesimin dhe ju dëshirojmë sukses në procesin e aplikimit.

Me respekt,

3. Pyetja nga Forumi për Integrim Social – FIS

I/E nderuar,

Drejtohemi tek ju me këtë kërkesë për sqarim rreth kriterëve të përshtatshmërisë për thirrjen publike per OJQ. Konkretisht, lidhur me kriterin e qarkullimit vjetor prej 200,000 euro, dëshirojmë të konfirmojmë nëse ky kriter mund të përmbushet përmes kumulimit (mbledhjes) së qarkullimit të dy partnerëve në rastin e një aplikimi në partneritet (konsorcium). Pyetjet tona specifike janë: 1. A është e pranueshme që shuma e kërkuar të arrihet si vlerë e përbashkët e qarkullimit të Aplikuesit Kryesor dhe Partnerit? 2. Në rast se jo, a duhet që ky kriter të plotësohet ekskluzivisht vetëm nga Aplikuesi Kryesor? Duke qenë se ky kriter është përcaktues për procesin tonë të aplikimit, do të vlerësonim lart një sqarim zyrtar nga ana juaj. Me respekt,

Përgjigja nga MAPL-ja:

I/E nderuar,

Duke u bazuar në Udhëzuesin e thirrjes publike, kriteret e përcaktuara, si dhe në Rregulloren e Ministria e Financave për kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, kriteri i qarkullimit financiar prej së paku 200,000 € gjatë tri (3) viteve të fundit duhet të plotësohet nga OJQ-ja/Aplikuesi Kryesor (lider).

Rrjedhimisht, nuk lejohet kumulimi apo mbledhja e qarkullimit financiar ndërmjet Aplikuesit Kryesor dhe partnerëve për të përmbushur këtë kriter.

Pra, ky kriter duhet të plotësohet ekskluzivisht nga Aplikuesi Kryesor.

Me respekt,

4. Pyetja nga RID (Integrimi Rajonal për Zhvillim)

I/E nderuar,

Si organizatë e interesuar për aplikim në Thirrjen Publike të datës 30.04.2026 (Nr. 453-316) për mbështetje financiare të OJQ-ve në fushën e qeverisjes lokale, pas shqyrtimit të kujdesshëm të dokumentacionit zyrtar – Thirrjes Publike dhe Udhëzimeve për Aplikantët – kemi identifikuar disa paqartësi dhe mospërputhje, për të cilat kërkojmë sqarim zyrtar përpara afatit të aplikimit. 1. Proporcionaliteti i kriterit të qarkullimit financiar Thirrja Publike (faqe 2, seksioni "Financimi") dhe Udhëzimet për Aplikantët (faqe 3, seksioni 1.3) përcaktojnë se shumt e financimit për një projekt janë nga 30,000.00 € deri në 80,000.00 €. Ndërkohë, Kriteri 4 i Udhëzimeve (faqe 4, seksioni 2.1) kërkon qarkullim minimal prej 200,000.00 € për 3 vitet e fundit. Kërkesa për qarkullim 2.5 deri në 6.6 herë më të lartë se vlera maksimale e grantit duket joproporcionale dhe potencialisht kufizuese për OJQ-të e profilizuara. Lutemi të specifikoni bazën ligjore mbi të cilën është përcaktuar ky kriter. 2. Zbatimi i Kriterit 4 (qarkullimi) për partnerët Udhëzimet për Aplikantët (faqe 4, seksioni 2.1, Kriteri 9) parashikojnë se partnerët lirohen vetëm nga kriteret 3, 5 dhe 9. Kriteri 4 – qarkullimi minimal 200,000.00 € – nuk figuron në listën e përjashtimeve, që nënkupton zbatim individual për secilin partner. Kërkojmë sqarim: a duhet ta plotësojë Kriteri 4 secili partner individualisht, apo vlerësohet qarkullimi kumulativ i konsorcionit në tërësi? 3. Mospërputhje në numrin e përfituesve Thirrja Publike (faqe 2, seksioni "Financimi") përcakton se MAPL planifikon të financojë deri në 10 projekte/propozime. Ndërkohë, Udhëzimet për Aplikantët (faqe 4, seksioni 1.3, paragrafi i fundit) specifikojnë se do të përzgjidhen "dy ose më shumë OJQ". Këto dy formulime janë në kundërshtim të drejtpërdrejtë me njëri-tjetrin. Kërkojmë sqarim mbi numrin e saktë të projekteve/përfituesve të synuar. 4. Mospërputhje në Kalendarin Indikativ Kalendarin Indikativ i Thirrjes Publike (faqe 3) dhe Udhëzimeve (faqe 11, seksioni 6) caktojnë si afat të fundit për dërgimin e pyetjeve datën 11.05.2026, dhe si afat të fundit për dërgimin e përgjigjeve gjithashtu datën 11.05.2026. Kjo e bën praktikisht të pamundur përfshirjen e sqarimeve në aplikim. Lutemi të konfirmoni nëse bëhet fjalë për gabim tipografik dhe të

specifikoni datën e saktë të kthimit të përgjigjeve. 5. Vetë-referenca e Kriterit 9 për partnerët Udhëzimet për Aplikantët (faqe 4, seksioni 2.1, Kriteri 9) parashikojnë se partnerët lirohen nga "kriteri numër 3, 5 dhe 9". Duke qenë se Kriteri 9 vetë përcakton kushtet e aplikimit në partneritet, përjashtimi i tij krijon një situatë logjiksht cirkulare. Lutemi të sqaroni çfarë synohet konkretisht me këtë përjashtim, veçanërisht në dallim nga Kriteri 8 i cili rregullon dorëzimin e dokumentacionit. Me respekt,

Përgjigja nga MAPL-ja:

I/E nderuar,

Ju falënderojmë për interesimin tuaj lidhur me Thirrjen Publike Nr. 453-316, datë 30.04.2026, për mbështetje financiare të OJQ-ve në fushën e qeverisjes lokale, si dhe për shqyrtimin me kujdes të dokumentacionit të publikuar.

Lidhur me çështjet e ngritura nga ana juaj, ju njoftojmë si në vijim:

Sa i përket kriterit të qarkullimit financiar prej 200,000.00 €

Ky kriter është përcaktuar në përputhje me dispozitat e Rregullores së Ministria e Financave për kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të organizatave joqeveritare, si dhe me vlerësimin institucional mbi kapacitetin financiar dhe operacional të aplikantëve për zbatimin e projekteve të financuara nga fondet publike. Ky kriter nuk mund të konsiderohet diskriminues në asnjë aspekt, pasi kërkesa për qarkullim financiar prej 200,000.00 € i referohet periudhës trevjeçare, që nënkupton mesatarisht rreth 67,000.00 € në vit. Kjo vlerë është dukshëm më e ulët se vlera maksimale e parashikuar për financim në kuadër të kësaj thirrjeje, e cila është deri në 80,000.00 €. Prandaj, kriteri është proporcional, i arsyeshëm dhe në funksion të sigurimit të kapaciteteve minimale financiare të aplikuesve për zbatimin e projektit.

Sa i përket aplikimit në partneritet

Kriteri i qarkullimit financiar nuk mund të përmbushet përmes kumulimit të qarkullimit ndërmjet partnerëve. Ky kriter duhet të plotësohet nga Aplikuesi Kryesor (OJQ lider), i cili bart përgjegjësinë kryesore kontraktuale dhe financiare për zbatimin e projektit.

Sa i përket numrit të projekteve që planifikohen të financohen

Numri maksimal i projekteve të planifikuara për financim, sipas Thirrjes Publike, është deri në dhjetë (10) projekte/propozime, varësisht nga cilësia e aplikimeve dhe fondet e disponueshme. Referenca "dy

ose më shumë OJQ" në Udhëzues i referohet mundësisë së aplikimit nga organizata individuale ose në partneritet, dhe nuk paraqet numrin e përfituesve.

Sa i përket Kalendarit Indikativ

Lidhur me datat e përcaktuara për pyetje dhe përgjigje, bëhet fjalë për një pasaktësi teknike në dokumentacion. Të gjitha sqarimet zyrtare do të publikohen/brenda afateve procedurale të përcaktuara nga autoriteti kontraktues.

Sa i përket kriterit për partnerët

Dispozitat lidhur me kriteret e aplikimit në partneritet duhet të interpretohen në tërësi me dokumentacionin e thirrjes. Partnerët i nënshtrohen vetëm kriterëve nga të cilat nuk janë shprehimisht të përjashtuar sipas udhëzimeve për aplikantët.

Për çdo informacion shtesë, ju lutemi referojuni dokumenteve zyrtare të publikuara në kuadër të thirrjes.

Me respekt,

5. Pyetja nga BONEVET Kaçanik

Pershendetje te nderuar,

Urojme te jeni mire.

Kemi një pyetje lidhur me kriteret e aplikimit per thirrjen. Te pika 10, kemi nevoje per sqarim nese vlera prej 200,000-euro e qarkullimit duhet te jete per secilin vit veç e veç, apo ne total per tri vitet.

"10. Dokument/e që dëshmojnë mbi qarkullimin e përgjithshëm financiarë të OJQsë gjatë 3 viteve të fundit para datës së publikimit të kësaj thirrje publike, të cilat duhet të jenë të barabarta me ose të tejkalojnë vlerën e përgjithshme 200,000.00 "

Ju faleminderit parapraksiht, mbesim ne pritje te pergjigjes tuaj.

Cdo te mire,

BONEVET Kaçanik

Përgjigja nga MAPL-ja:

I/E nderuar,

Ju falënderojmë për interesimin tuaj lidhur me Thirrjen Publike.

Duke u bazuar në Udhëzuesin për aplikantët dhe kriteret e përcaktuara në thirrjen publike, vlera prej 200,000.00 € i referohet **qarkullimit të përgjithshëm financiar në total për tri (3) vitet e fundit** para datës së publikimit të thirrjes publike, dhe jo qarkullimit për secilin vit veç e veç.

Pra, dëshmitë financiare të paraqitura duhet të tregojnë që qarkullimi i përgjithshëm kumulativ për periudhën trevjeçare të jetë i barabartë me ose ta tejkalojë shumën prej 200,000.00 €.

Me respekt,

Ministria e Administrimit të Pushteti Lokal